

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit
KM-MIT

Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
2

Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. **212/19**
 Data : Datum : **19.04.19**
 Date : **19.04.19**

PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit
01

Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
01

Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. **4152**
 Data : Datum : **19.04.19**
 Date : **19.04.19**

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Refuzohet kërkesa nr.2152 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Vaidi" shpk me seli në Ferizaj për marrjen e nisjes ne relacionin: Ferizaj-Prishtinë dhe anasjelltas me orare te nisjes (06:15 - 07:30).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, ka konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "Vaidi" shpk me seli në Ferizaj i cili ka aplikuar për marrjen e nisjeve ne relacionin:

Ferizaj - Prishtinë dhe anasjelltas me orare te nisjes (06:15 - 07:30) është mjaft mire e mbuluar me nisje ekzistuese te miratuara nga MIT-ja tek operatoret respektiv.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Pal LEKAJ

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.